



STATUT

i

SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR

Emertuar

“EURON ” SHPK

KREU I

Dispozita te pergjithshme

Neni 1

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar “EURON ” SHPK eshte regjistruar si person juridik ne daten 08.03.1994, me NIPT J71317002N. Regjistrimi i saj eshte bere ne perputhje me Aktin e Themelimit dhe Statutin e shoqerise .

Ne perputhje me Nenin 230 , pika 2 te Ligjit Nr. 9901 , date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare” dhe Ligjit nr. 9723 date 03.05.2007 “ Per Qendren Kombetare te Regjistrimit “ , te ndryshuar , hartohet ky Statut nga Ortaket themelues .

Neni 2

Shoqeria ka dy ortake themelues:

1.Gezim ÇELA, i biri i Sokol Çela, i datelindjes 03.03.1964, lindur ne Kukes dhe banues ne Selite , Komuna Farke , Tirane (prane Kopeshtit Botanik), me shtetsi shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit ID Nr 030367006,

2.Kujtim SHPATA, i biri i Rushit Shpata, i datelindjes 24.02.1969 lindur ne dhe banues ne Tirane, Selite , Komuna Farke , Tirane (prane Kopeshtit Botanik), me shtetsi shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit ID Nr.027785014.

KREU II

EMERTIMI, SELIA, FORMA, KOHEZGJATJA, OBJEKTI, VULA,

Neni 3

Emertimi

Emertimi i shoqerise eshte “EURON” SHPK.

Neni 4

Selia

Qendra e selise te shoqerise tregtare me pergjegjesi te kufizuar “EURON” shpk eshte ne Tirane , Farke , Selite, Pallati “Euron 1” , Hyrja 1 , Njesia 1 .

Gjate veprimtarise se saj , shoqeria ka te drejte te krijojë dege dhe filiale ne qytete dhe rrethe te tjera te vendit si edhe jashte shtetit, duke respektuar legjislacionin e shtetit perkates.

Neni 5

Forma Juridike

Shoqeria "EURON" shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur "Shoqeria").

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Shoqëria "EURON" shpk, është një e tillë, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët, që përballojnë personalisht humbjet e shoqërisë deri ne pjesen e pashlyer te kontributeve te nenshkruara.

Neni 6

Kohezgjatja

Kohezgjatja e shoqërisë ne baze te ketij Statuti eshte e pa kufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit te saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit. Shoqeria mund te prishet ose te pushoje aktivitetin e saj me nje vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne baze te Ligjit 9901 date 14.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare "dhe statutit te shoqërisë.

Neni 7

Objekti i veprimtarise se shoqërisë do te jete:

Objekti i veprimtarise se shoqërisë me pergjegjesi te kufizuar "EURON" shpk eshte :

Veprimtari ne fushen e Ndertimit , Projektimit dhe Supervizimit si dhe aktivitetet Prodhuese , Tregtare dhe Financiare te lidhura me to.

Neni 8

Vula e Shoqërisë

Shoqeria ka vulen e saj, ne brendësi të së cilës shkruhet i plote emertimi i shoqërisë .

Të gjitha aktet që dalin nga shoqëria, pasi nënshkruhen sipas ligjit, vulozen me vulën e shoqërisë.

KREU III

KAPITALI THEMELTAR - PJESEMARJA.

Neni 9

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i Shoqërisë sipas vendimit te Asamblese se Pergjitheshme te Ortakeve eshte 100 000 Leke (njqind mije). Kapitali eshte i ndare ne 100 kuota, me vlere nominale 1 000 leke seicila.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht në te holla nga ortakët e shoqërisë.

Kapitali i shoqërisë nuk mund te jete me i vogel se 100 leke.

Neni 10

Pjesmarria

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe shlyer tërësisht në te holla nga ortakët e shoqërisë, përkatesisht :

1- Gezim Cela. 50 000 leke , 50 % te kuotave

2- Kujtim Shpata 50 000 leke , 50 % te kuotave

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme dhe as me kontribute në shërbime.

Neni 11

Menyra e fitimit dhe kalimit te kuotave

1. Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet :

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar ne ligj.

2. Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

3. Çdo transferim i kuotave tek te tretet behet me vendim te Asamblese se Pergjitheshme te ortakeve, duke redaktuar dhe akt noterial per transferimin e kuotave.

Çdo transferim i kuotave tek te tretet i nenshtrohet te drejtes se parablerjes nga ortaket e tjere te shoqerise.

Ortaku qe merr nje vendim per te transferuar kuotat e tij, perpara duhet t'i komunikojë Asamblese se Pergjitheshme te Ortakeve projektin e transferimit. I takon ortakeve te tjere te ushtrojne te drejten e parablerjes. Ne se ortaket nuk i japin pergjigje brenda nje muaji nga marrja e projektit te transferimit, miratimi quhet i dhene. Brenda nje muaji nga marrja e projektit te transferimit ortaket e tjere te shoqerise duhet te japin miratimin me shkrim te ketij transferimi te kuotave ne persona te trete. Kushtet e ofruara te treteve nuk duhet te jene me te favorshme nga ato te ofruara ortakeve.

Ne rast se lind nevoja e vleresimit te kuotave, Asambleja e Ortakeve me unanimitet cakton Ekspert Kontabel, qe mund te jete ai qe ben miratimin e llogarive vjetore te shoqerise ose edhe nje tjeter i jashtem. Ne rast se kjo gje nuk arrihet me marreveshje , Eksperti caktohet nga Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 12

Rritja e kapitalit

Shoqeria mund te rrise Kapitalin Themeltar ne para ose ne natyre (pasuri te luajtshme, apo te paluajtshme), ose mund ta zvogeloje ate, por jo nen kufirin minimal qe lejon ligji Nr 9901, dt 14.04.2008 "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregetare" (pjesa per Sh.P.K).

Shtimi ose zvogelimi i kapitalit behet me vendim te Asamblese se Pergjitheshme te Ortakeve te shoqerise.

Dokumentet depozitohen ne QKR, e cila ben ndryshimet perkatese.

KREU IV ORGANIZIMI I SHOQERISE

Neni 13

Organet Drejtuese

Organet Drejtuese te Shoqerise jane:

- Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve.
- Administratori i Shoqerise.

Asambleja e Pergjithshme e Ortakeve

1.Asambleja e Pergjithshme eshte pergjegjese per marrjen e vendimeve per shoqerine, per çeshtjet e meposhtme:

- a.percaktimin e politikave tregtare te shoqerise;
 - b.pdryshimin e statutit,
 - c.emerimin e shkarkimin e administratoreve,
 - d.emerimin e shkarkimin e likujdueseve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar,
 - e.percaktimin e shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat "c" dhe "ç" te kesaj pike,
 - dh.mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret ,perfshi pergatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
 - e.miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise,
 - é.zmadhimin dhe zvogelimin e kapitalit,
 - f.pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre,
 - g.perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve,
 - gj.rriorganizimin dhe prishjen e shoqerise,
 - h.miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese,
 - i.çeshtje te tjera te parashikuara nga ligji dhe statuti.
2. Asambleja e Pergjithshme merr vendime per çeshtje te percaktuara ne pikat "e", "ë" te pikes 1 te ketij neni , pas marrjes ne shqyrtim te dokumentave perkatese.

Neni 14

Mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve

- 1.Asambleja e pergjithshme mblidhet ne rastet e percaktuara nga ky ligj, nga ligje te tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa here qe mbledhja eshte e nevojshme per te mbrojtur interesat e shoqerise. Mbledhja e zakonshme e asamblese se pergjitheshme thirret te pakten nje here ne vit.
- 2.Asambleja e pergjitheshme thirret nga administratoret apo ortaket e percaktuar sipas nenit 84 te Ligjit.
- 3.Asambleja e pergjitheshme thirret nese, sipas bilancit vjetor apo raporteve te ndermjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku qe aktivet e shoqerise nuk i mbulojne detyrimet e kerkueshme brenda 3 muajve ne vazhdim.
- 4.Asambleja e pergjitheshme thirret kur shoqeria propozon te shese apo te disponoje ne menyre tjeter aktive, te cilat kane nje vlere me te larte se 5 % te asetave te shoqerise , qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
5. Asambleja e pergjitheshme thirret kur shoqeria, brenda 2 viteve te para pas regjistrimit te saj, propozon te bleje nga nje ortak pasuri, qe kane vlere me te larte se 5 % te asetave te shoqerise, qe rezulton ne pasqyrat e fundit financiare te çertifikuara.
- 6.Ne rastet e parashikuara ne pikat 3 dhe 5 te ketij neni, asamblese se pergjitheshme i paraqitet nje raport nga nje ekspert kontabel i autorizuar , i pavarur.
- 7.Dispozitat e pikes 6 te ketij neni nuk zbatohen nese blerjet, sipas pikave 4 dhe 5 te ketij neni, kryhen ne burse ose jane pjese e veprimeve te perdritshme te shoqerise dhe behen ne kushte normale tregu.Gjithashtu, keto dispozita nuk zbatohen ne rastin kur shoqeria zoterohet nga nje ortak i vetem.
- 8.Ne rastet e parashikuara ne pikat 3, deri ne 5 te ketij neni, asambleja e pergjitheshme mund te miratoje nje rezolute keshilluese , duke miratuar apo bere verejtje per veprimtarine e administratoreve.

Neni 15

Menyra e thirrjes

- 1.Asambleja e pergjitheshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose edhe nepermjet postes elektronike. Njoftimi duhet te permbaje vendin, daten, oren e mbledhjes, rendin e dites e t'u dergohet te gjithë ortakëve, jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.
- 2.Kur asambleja e pergjitheshme eshte thirrur sipas pikes 1 te ketij neni, ajo mund te marre vendime te vlefshme, vetem nese te gjithë ortakët jane dakort per te marre vendime, pavaresisht parregullsive.

[Signature]

[Signature]

Neni 16

Kerkesat nga ortakët e pakicës

1.Ortakët, të cilët përfaqësojnë të paktën 5 % të totalit të votave në asamblenë e përgjithshme të shoqërisë, mund t'i drejtojnë administratorëve një kërkesë me shkrim ose me postë elektronike, për të thirrur asamblenë e përgjithshme dhe përfshirjen e çështjeve të posaçme në rendin e ditës.Kërkesa duhet të përmbajë arsyet,objektivat dhe çështjet ,për të cilat asambleja duhet të marrë një vendim.Nëse kërkesa refuzohet , këta ortakë kanë të drejtë ta tërresin asamblenë dhe të caktojnë çështjet e rendit të ditës , në përputhje me pikën 1 të nenit 83 të këtij ligji.

2.Nëse, në kundërshtim me pikën 1 të këtij neni, asambleja e përgjithshme nuk thirret, ose çështjet e kërkuara prej këtyre nuk futen në rendin e ditës, secili prej ortakëve që kanë bërë kërkesën, ka të drejtë :

a.të ngrejë padi në gjykatë për të deklaruar shkeljen e detyrimit të besnikërisë, nëse administratorët nuk përmbushin kërkesat e ortakëve brenda 15 ditëve,

b.t'i kërkojë shoqërisë blerjen e kuotave të zotëruara prej tyre.

3.Në rastet kur rendi i ditës ndryshohet, sipas parashikimeve të pikave 1 e 2 të këtij neni dhe thirrja i është njoftuar ortakëve, administratorët njoftojnë perseri rendin e ditës, të ndryshuar, në përputhje me parashikimet e pikës 1 të nenit 83 të ligjit.

4. përfaqësuesi i autorizuar është i detyruar të deklarojë çdo fakt apo rrethane , të tilla që , sipas gjykimit të ortakut të përfaqësuar, rrezikon të ndikojë në vendimmarrjen e përfaqësuesit për interesat e tjera të ndryshëm nga ato të ortakut të përfaqësuar.

Neni 17

Përfaqësimi në asamble

1.Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të autorizimit nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

2.Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

3.Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblese së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjen vijuese me të njëjtin rend dite.

Neni 18

Kuorumi

1.Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zotërojnë më shumë se 30 % të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar, sipas nenit 87 të ligjit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme , vetëm nëse ortakët që zotërojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht,votojnë me shkrese, apo mjete elektronike.

2. Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mbledhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendur në pikën 1 të këtij neni, asambleja mbledhet perseri jo më vonë se 30 ditë , me të njëjtin rend dite.

Neni 19

Marrja e vendimeve

1.Me përjashtim të rasteve kur statuti përshikon një shumicë me të lartë, asambleja e përgjithshme vendos me tri të katërtat e votave të ortakëve pjesëmarrës, siç përcaktohet në pikën 1 të nenit 86 të ligjit, por ndryshimet e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

2. Me përjashtim të rasteve kur përcaktohet në ligj, për çështjet e tjera të renditura në nenin 81 të ligjit, asambleja e përgjithshme vendos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës.

3.Me perjashtim te rasteve kur parashikohet ndryshe ne ligj, vlefshmeria e vendimeve qe percaktojne detyrime shtese mbi ortaket, apo vendimet qe kufizojne te drejtat e tyre, te parashikuara ne ligj, kushtezohen me miratimin e ortakut perkates.

Neni 20

E drejta e votes

- 1.Çdo kuote jep te drejten e nje vote.
- 2.Ortaket qe nuk mund te marrin pjese ne mbledhjen e asamblese se pergjitheshme , kane te drejte te votojne me mjete elektronike, sipas përcaktimeve ne nenin 88 te ligjit.

Neni 21

Perjashtimi nga e drejta e votes

- 1.Ortaku nuk mund te ushtroje te drejten e votes nese asambleja e pergjithshme merr vendim per:
 - a.vleresimin e veprimtarise se tij,
 - b.shuarjen e ndonje detyrimi ne ngarkim te tij,
 - c.ngritjen e nje padie ndaj tij nga shoqeria,
 - ç.dhenien ose jo te perfitimeve te reja.
- 2.Kur ortaku perfaqesohet nga nje perfaqesues i autorizuar, i autorizuari vleresohet te jete ne te njejtin konflikt interesi, ashtu si dhe ortakut, te cilin perfaqeson.

Neni 22

Procesverbalet e mbledhjes se asamblese

- 1.Te gjitha vendimet e asamblese se pergjithshme duhet te regjistrohen ne procesverbal. Administratoret pergjigjen per ruajtjen e kopjeve te procesverbaleve te mbledhjeve te asamblese se pergjitheshme.
- 2.Procesverbali duhet te permbaje daten e vendin e mbledhjes, rendin e dites, emrin e kryetarit e te mbajtesve te procesverbalit, rezultatin e votimit.
- 3.Procesverbalit i bashkelidhet edhe lista e pjesmarresve, si dhe akti i thirrjes se asamblese se pergjithshme.
4. Procesverbali i mbledhjes nenshkruhet nga kryetari dhe nga mbajtesi i procesverbalit.
- 5.Nese shoqeria ka publikuar nje faqe ne internet, administratoret, jo me vone se 15 dite nga data e mbledhjes jane te detyruar te publikojne kopje te procesverbalit te mbledhjes se asamblese se pergjithshme ne kete faqe.

ADMINISTRATORET

Neni 23

Emerimi, shkarkimi, te drejtat dhe detyrimet

- 1.Asambleja e pergjithshme emron nje ose me shume persona fizik si administratore te shoqerise. Afati i emrimit te administratorit nuk mund te jete me teper se 5 vjet, me te drejte rizgjedhje (sipas nenit 95 te ligjit).
2. Nese asambleja e pergjithshme emeron me shume se nje administrator, ata e administrojne bashkërisht shoqerine.
- 3.Asambleja e pergjithshme mund te shkarkoje administratorin ne çdo kohe me shumice te zakonshme. Statuti apo marrëveshje te tjera nuk mund te perjashtojne apo te kufizojne kete te drejte. Padite qe lidhen me shpërblimin e administratorit, ne baze te marrëveshjeve kontraktore me shoqerine , rregullohen sipas dispozitave ligjore ne fuqi.
4. Asambleja e pergjithshme e shoqerise emron Administrator te Shoqerise “-EURON” Sh.p.k. z. **Gezim Sokol Çela** , me afat 5 vjet, me te drejte rizgjedhje .

Gezim Sokol Çela

Shoqeria

Neni 24

Te drejtat e detyrimit e Administratorit

1. Administratorët kanë të drejta dhe detyrohen të:

- a) kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare;
- b) përfaqësojnë shoqërinë tregtare;
- c) kujdesen për mbajtjen e sakte e tërregullt të dokumentave dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- d) përgatisin dhe nënshkruajnë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecures se veprimtarisë;
- e) krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcenojnë mbarevajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- f) kryejnë regjistrimet dhe dergojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në Ligjin për QKR.
- g) raportojnë përpara asamblëse se përgjithëshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të vëçante për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;
- h) kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut;
- i) administratori, gjatë kryerjes së detyrës së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimin e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim;
- j) nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe ligjin, është i detyruar t'i dëmshperblejë shoqërisë dëmet që rrjedhin nga kyerja e shkeljes, si dhe të kalojë çdo fitim personal që ai apo çdo person i lidhur me të kanë përfituar nga këto veprime të parregullta.

2. Në rastet e parashikuara në pikat 3 dhe 5 të nenit 82 të Ligjit të lartcituara, administratorët janë të detyruar të thërrasin asamblëne të përgjithëshme.

3. Shperblimi i administratorëve bëhet në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 97 të ligjit.

4. Detyrimet e besnikërisë të administratorëve duhet të jete në përputhje me nenin 98 të ligjit.

KREU V FINANCAT

Neni 25

Kontrolli Financiar dhe aprovimi i llogarive

Kontrolli Financiar i Shoqërisë dhe aprovimi i llogarive vjetore (Bilanci vjetor) kryhet nga një Ekspert Kontabel i Autorizuar, i emëruar nga Asambleja e përgjithëshme e Ortakëve për një periudhë 3 vjeçare, me mundësi ri-emërimi.

Neni 26

Periudha Financiare

Çdo vit financiar fillon në 1 Janar e përfundon në 31 Dhjetor të çdo viti, me përjashtim të vitit të parë kur si fillim është data e regjistrimit në gjykatë e shoqërisë.

Neni 27

Miratimi i Llogarive Vjetore

Llogaritë vjetore, inventaret, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e veçanta të hartuara nga Ekspertet Kontabel të Autorizuar miratohen nga Asambleja e Zakonshme e Ortakëve. Miratimi i dokumentave financiarë vjetore bëhet brenda afatit ligjor të mbylljes së llogarive për një periudhë 3-mujore mbas datës së mbylljes së vitit ushtrimor.

Neni 28

Shperndarja e Fitimit

Fitimi i realizuar nga ushtrimi i veprimtarise ekonomike te Shoqerise , sipas deklarimit ne pasqyrave financiare te shoqerise, do te administrohet nga Ortaket e Shoqerise. Nje pjese e ketij fitimi mund te perdoret per zgjerimin e aktivitetit tregtar. Shoqeria eshte e detyruar te shlyeje te gjitha detyrimet qe ka ndaj shtetit dhe te tretëve dhe fitimi qe rezulton ndahet sipas kuotave.

Neni 29

Kufizimet e shperndarjeve, çertifikata e aftesise paguese

1. Shoqeria mund t'u shperndaje fitime ortakeve, vetem nese pas pagimit te dividendit:

a. aktivet e shoqerise mbulojne teresisht detyrimet e saj,

b. shoqeria ka aktive likuide te mjaftueshme per te shlyer detyrimet qe behen te kerkueshme brenda 12 muajve ne vazhdim,

2. Administratoret leshojne nje çertifikate te aftesise paguese, e cila konfirmon shprehimisht se shperndarja e propozuar e dividendeve permbush kerkesen e pikes 1 te ketij neni , ndersa kur gjendja e shoqerise tregon se shperndarja e propozuar e dividendeve nuk i permbush keto kriteret, administratoret nuk mund ta leshojne kete çertifikate.

3. Administratoret pergjigjen ndaj shoqerise per vertetesine e çertifikates se aftesise paguese.

Neni 30

Pergjegjesia personale per shperndarjen e ndaluar

1. Administratoret, te cilat nga pakujdesia leshojne nje certificate te pasakte te aftesise paguese, sipas pikes 2 te nenit 77 te Ligjit 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtaret dhe Shoqëritë Tregtare", pergjigjen personalisht perpara shoqerise per kthimin e dividendeve te shperndare.

2. Ortaket, qe kane marre nga shoqeria dividende, pergjigjen personalisht ndaj shoqerise per kthimin e dividendeve qe u jane shperndare kur nuk eshte leshuar çertifikata e aftesise paguese, ose kur, pavaresisht leshimit te çertifikates, keta ortake kane pasur dijeni per gjendjen e paaftesise paguese te shoqerise, sipas pikes 1 te nenit 77 te ketij ligji, ose ne baze te rrethanave te qarta nuk mund te mos kishin pasur dijeni per kete gjendje.

Neni 31

Marredheniet me Bankat dhe Institutet Financiare

Shoqeria ka te drejte te çel (hap) llogari likujduese prane nje ose me shume bankave ose institutete financiare dhe te mund te kryeje veprime likujduese prane bankave. Ne keto banka ose institute financiare si **Firme e pare** do te depozitohet **ajo e Administratorit te Shoqerise, Gezim Sokol Çela** , i cili duhet te firmosi per te gjitha veprimet financiare ne emer e per llogari te shoqerise.

Neni 32

Pergatitja e Llogarive vjetore

Veprimtaria ekonomike e Shoqerise mbaron me 31 Dhjetor te çdo viti. Administratori ose personat e caktuar prej tij jane te detyruar te paraqesin bilancin vjetor dhe deklarimin e te ardhurave, dhe t'i depozitojne ato ne organin Financiar te Zyres se Tatimeve.

KREU VI

MARREDHENIET E PUNESIMIT DHE ME TE TRETET

Neni 33

Punesimi

Marredheniet e punesimit brenda shoqerise rregullohen nepermjet kontrates individuale te punesimit qe lidhet midis paleve ne perputhje me ligjin nr 7961, date 12.07.1995 'Kodi i Punes ne Republiken e Shqiperise (me ndryshimet perkatese), si dhe gjithe legjislacionin Shqiptar qe ben fjale per punesimin.



Neni 34

Marria dhe largimi nga puna

Marria ne pune e personave te tjere (jo ortake te shoqerise) behet me deklarimin e tyre ne Zyren e Punes dhe prane organeve te Sigurimeve Shoqerore (Zyra Rajonale Tirane) si dhe me regjistrimin e tyre ne Regjistrin e te Punesuarve prane Shoqerise.

Largimi nga puna ose ndryshimi i vendit te punes behet ne baze te nje akti me shkrim te leshuar nga Administratori i Shoqerise. Largimi lidhet me mbarimin e afatit te kontrates se punes, kur konstatohen shkelje disiplinore ose me vete kerkesen e te interesuarit.

Largimi nga puna behet pasi te jene shlyer te gjitha detyrimet materiale e monetare te individeve ndaj shoqerise e anasjelltas.

Neni 35

Lidhja e kontratave

Shoqeria mund te lidhe kontrata me sektore shtetere, sektore private ose tregun e lire, si dhe me persona fizike e juridike, vendas ose te huaj. Ne veprimtarine e saj kontraktuale , Shoqeria perfaqesohet nga Administratori i saj . Ajo mund te perfaqesohet edhe nga persona te tjere te autorizuar prej Administratorit, me prokure te posaçme ose te pergjithshme.

Te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga marredheniet kontraktuale te lidhura si me siper jane te detyrueshme per shoqerine.

KREU VII PRISHJA E SHOQERISE

Neni 36

Prishja e Shoqerise

Shoqeria me pergjegjesi te kufizuar priset :

- a. kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b. me vendim te asamblese se pergjithshme;
- c. me hapjen e procedurave te falimentimit;
- d. nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9323,date 3.5.2007 "Per Qendren Kombtare Tregtare te Regjistrimit";
- e. me vendim te gjykates;

Neni 37

Procedurat e prishjes se Shoqerise

- 1.Administratoret regjistrojne prishjen e shoqerise prane QKR ne perputhje me nenin 43 te ligjit nr.9323, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Nese prishja e shoqerise behet me vendim te gjykates, gjykata ne perputhje me nenin 45 te ligjit te sipercituar ia njofton vendimin QKR.
- 2.Per kryerjen e ketij procesi (Prishjen e shoqerise) emerohen nje ose me shume Likujdator, te cilet ndjekin operacionin e likujdimit deri ne fund dhe i paraqesin Asamblese se pergjithshme te ortakeve rezultatet e perfundimtare te likujdimit.
- 3.Ne perfundim, Asamblea e pergjithshme e Ortakeve vendos per heqjen e mandatit te tyre. Te gjitha detyrimet qe dalin nga akti i likujdimit , Asamblea e Ortakeve i merr persiper ti shlyej me kapitalin e ortakeve te Shoqerise, sipas legjislacionit shqiptar per kete qellim .
- 4.Çdo dokument i prodhuar ne kete periudhe duhet te dale ne emer te Likujdatorit dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesën shtese " Shoqeri ne likuidim e siper ".
5. Çdo vendim i marre ne kete drejtim, depozitohet ne QKR per te bere shenimet e duhura.

**KREU VIII
TE NDRYSHME**

Neni 38

Zgjidhja e mosmarreveshjeve

Te gjitha mosmarreveshjet qe nuk mund te zgjidhen me mirekuptim brenda Shoqerise si dhe ato qe Shoqeria ka me te trete apo edhe midis vete ortakeve te saj, zgjidhen ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Tirane.

Neni 39

Hartimi i Statutit te Shoqerise

Statuti eshte hartuar me vullnetin e lire te plote te paleve (Ortakët Themelues) dhe eshte nenshkruar prej tyre perpara noterit publik. Statuti hartohet ne tre kopje per t'u depozituar : nje ne QKR, nje kopje mbetet ne dokumentacionin baze te Shoqerise, ndersa kopja tjeter arkivohet tek noteri publik.

Neni 40

Te Tjera

Çeshtjet e tjera te pa trajtuara ne kete Statut do te mbeshteten per zbatim ne legjislacionin Shqiptar ne fuqi, sipas rastit konkret ne Ligjin 9901 date 14.04.2008, " Per Tregtarete dhe Shoqëritë Tregtare", ne Ligjin Nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qëndrën Kombetare të Regjistrimit", ne Kodin Civil ne fuqi si dhe ne akte te tjera ligjore e nenligjore te dala ne zbatim te tyre.

ORTAKET THEMELUES TE SHOQERISE

" EURON " SH.P.K.

1. QAZIM BEU SULE

2. KUPTIM SHPATA SPOTAJ

REPUBLIKA E SHQIPERISE
DHOMA E NOTEREVE RRETHIT

Nr. 1847 Rep.

Nr. 485 Kol.

VERTETIM

Ne qytetin e Tiranes, sot në daten 16 / 05 / 2011 (dy mijë e njemdhjetë), perpara meje noterit Xhevdet HAMZAJ , anetar i Dhomes se Noterve Tirane , u paraqiten personalisht :

1.Gezim Çela, i biri i Sokol Çela, i datelindjes 03.03.1964, lindur ne Kukes dhe banues ne Tirane, Selite , Komuna Farke , Tirane, me shtetsi shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit ID Nr 030367006,

2.Kujtim Shpata, i biri i Rushit Shpata, i datelindjes 24.02.1969 lindur ne dhe banues ne Tirane, Selite , Komuna Farke , Tirane, me shtetsi shqiptar, madhor, me zotesi te plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit ID Nr.027785014.

Personat e mesiperm , me cilesine e Ortakeve te Shoqerise Tregtare me Pergjegjesi te Kufizuar "EURON" Sh.P.K. deklaruan se ne perputhje me Nenin 230 , pika 2 e Ligjit Nr. 9901 , date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe Ligjin nr. 9723 date 03.05.2007 " Per Qendren Kombetare te Regjistrimit " , te ndryshuar, kane hartuar Statutin e Shoqerise "EURON " shpk, duke pershtatur organizimin dhe funksionimin e shoqerise me kete ligj dhe e nenshkruan personalisht ate perpara meje noterit.

Une Noteri vertetoj rregullsine dhe bazueshmerine e redaktimit ne ligj të ketij akti si dhe autenticitetin e nenshkrimeve, me cilesine qe me njeh neni 55 i Ligjit nr. 7829, date 01.06.1994 " Per Noterine " ne Republiken e Shqiperise.



NOTER

Xhevdet B. Hamzaj
[Signature]

IDENTIFICATION ID

REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

mbiemri/surname

Shpata

emri/given name

Kujtim

shkësitë/nationality

Shqiptare/Albanian

vendndëshja/place of birth

Patos, Fier

datë e lindjes/date of birth

24-02-1969

datë e testimit/date of issue

26-10-2009

autoriteti /thues/authority

MB

nr. lidhënjësh/kard no.

027785014

gjinia/sex

M

datë e skadencës/date of expiry

25-10-2019

nr. personal/personal no.

G90224186H



Imazhi/signature

Kujtim Shpata

IDENTIFICATION ID

REPUBLIKA E SHQIPERISE REPUBLIC OF ALBANIA

mbiemri/surname

Cela

emri/given name

Gëzim

shkësitë/nationality

Shqiptare/Albanian

vendndëshja/place of birth

Kukes

datë e lindjes/date of birth

03-03-1964

datë e testimit/date of issue

18-12-2010

autoriteti /thues/authority

MB

nr. lidhënjësh/kard no.

030367006

gjinia/sex

M

datë e skadencës/date of expiry

17-12-2020

nr. personal/personal no.

G40303157Q



Imazhi/signature

Gëzim